



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përhershëm / Kancelarija Stalnoq Sekretara / Office of the Permanent Secretary

DATË/A:	25.05.2018
REFERENC-Ë:	17/4221/595/DMMU
PËR/ZA/TO:	"Vocolli" Sh.p.k. Brecë- Podujevë Ekspluatim, thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Z. Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të kompanisë "Vocolli" Sh.p.k. Brecë- Podujevë, me nr. prot. 17/4221/595/DMMU të datës: 24.08.2017.

MMPH pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, bien vendimin i cili i bashkëngjitet kësaj letërpërcjellëse së bashku me Shtojcën:

- Vendimi për Leje Mjedisore për kompaninë "Vocolli" Sh.p.k. Brecë- Podujevë, për veprimtaritë: eksploatim, thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror në lokacionin Brecë- Podujevë.
- Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 dhe Udhëzimi Administrativ për Leje Mjedisore Nr. 07/2017.

Me respekt

Faqe 1 nga 3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning*

Zyra e Sekretarit të Përhershëm / Kancelaria Stalnoq Sekretara / Office of the Permanent Secretary

Në bazë të nenit 31, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 dhe Udhëzimit Administrativ për Leje Mjedisore nr. 07/2017, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, bie këtë:

V E N D I M

Leje Mjedisore

Kompanisë "Vocolli" Sh.p.k. Brecë- Podujevë, për veprimtaritë: eksploitim, thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror në lokacionin Brecë- Podujevë.

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore, vizitës në teren dhe shqyrtimit të informatave shtesë për kompaninë "Vocolli" Sh.p.k. Brecë- Podujevë, për veprimtaritë: eksploitim të gurit gëlqeror në ngastrën nr. 285, si dhe thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror në ngastrat kadastrale nr. 282 dhe nr. 283, zona kadastrale Brecë- Podujevë. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, vlerëson se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr Vendim për leshuarjen e **Lejes Mjedisore**. Kompanisë në fjalë i **refuzohet kërkesa për tu pajisur me Leje Mjedisore për veprimtarinë eksploitim të gurit gëlqeror, në ngastrën kadastrale 473-1 dhe 476, Zona kadastrale Tërrenavicë- Podujevë, pasi që mungon Leja për aktivitete të veçanta (për eksploitim të gurit gëlqeror) nga KPMM.**

Për veprimtaritë të cilat jeni të pajisur me Leje Mjedisore obligoheni të i përmbahuni kushteve të cekura me poshtë:

- Të bëhet monitorimi i vazhdueshëm i pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike, vlerat kufitare të cilësisë së ajrit të jenë në nivelin e lejuar;

Faqe 2 nga 3



- Raporti i rezultateve për monitorimin e cilësisë së ajrit sipas dinamikes së përcaktuar me legjislacion të i dorëzohet MMPH-s;
- Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës të njoftoj MMPH;
- Sistemi i ujitjes të jetë funksional;
- Të mirëmbahet thurja e ngastrës ku behet shfrytëzimi i gurit gëlqeror;
- Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit inxhinierik që është përgjegjës për mjedis;
- Pas përfundimit të veprimtarisë, operatori është i obliguar të kthej lokacionin në gjendjen e mëparshme.

Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, komfor nenit 31 paragrafi 2. të Ligjit për Mbrojtje e Mjedisit Nr. 03/L-25 dhe Udhëzimit Administrativ për Leje Mjedisore nr. 07/2017.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes së tij.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 17/4221/ZSP/119/18 datë: 25.05.2018.

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komunës
3. DMMU-së
4. Inspektoratit
5. Kabinetit të Ministrit
6. Arkivit të MMPH-së


 Arben CITA KU
 Sekretar i Përgjithshëm

Faqe 3 nga 3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave / Department of Environment Protection and Water / Departament za Zivotnu Sredinu i Vodu

DATË/A:	25.05.2018
REFERENC-Ë:	17/4221/595/DMMU
PËR/ZA/TO:	Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Muhamet Malsiu, Drejtor i Departamentit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Flet përcjellëse për lëshuarjen e Lejes Mjedisore

Bazuar në kërkesën e bërë nga kompania "Vocolli" Sh.p.k. Brecë- Podujevë, me nr. prot. 17/4221/595/DMMU, për tu pajisur me Leje Mjedisore për veprimtaritë: eksploitim, thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror në lokacionin Brecë dhe Tërrenvicë- Podujevë, Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

Me respekt,

Faqe 1 nga 1